



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

C.nr.672/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, gjyqtari Naim Mehulli, me procesmbajtësen Fetije Pireva, në kontestin e paditëses BKS me seli në ... rr. “.....” pn, të cilën e përfaqëson me autorizim LH, kundër të paditurit EZ nga, te cilin e përfaqëson Av.AD sipas autorizimit me shkrim, për shkak të rimbursim dëmi-regres, vlera e kontestit 3739€ , pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 07.05.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit **BKS** me seli në, rr. “.....” pa nr.

II. DETYROHET i padituri **EZ** nga, që në emër të, rimbursim dëmi-regres ti kompensoj paditëses BKS nga, shumën në lartësi prej **3739 euro** (tre mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë euro), si dhe shpenzimet procedurale t’ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 25€ euro, me kamat sikurse për mjetet e deponuara bankare pa destinim te caktuar prej ditës së nxjerrjes se këtij aktgjykimi, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi BKS me seli në, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurit EZ nga, për shkak të rimbursimit dëmi-regres, duke cekur se i padituri me datë 19.09.2012 në ora 17:50 minuta me automjetin e tij “Motoçikletë” me targa te regjistrimit 01-710-AA, ka shkaktuar aksident trafiku , me ç ‘rast motoçikleta me të cilin i padituri ka shkaktuar aksident trafiku ka goditur NS, i padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë i pa siguruar, respektivisht i kishte skaduar afati i periudhës së sigurimit në momentin e aksidentit. E dëmtuara në këtë aksident NS, përmes te autorizuarit te tyre Av. MH ka bërë kërkesë fillimisht pre akontacion e me vonë për kompensim dëmi ndaj këtu paditëses.

Sipas Ligjit nr.04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia të Republikës ë Kosovës, BKS ka qenë e obliguar që këtë dëm t’ia kompensojmë të dëmtuarit dhe të njëjtin të rimbursojmë nga shkaktari i aksidentit-respektivisht nga i padituri në rastin konkret, prandaj paditësja BKS fillimisht me datën 10.01.2013 ka arritur Marrëveshje Jashtëgjyqësore me te cilin palës se dëmtuar NS ju ka kompensuar akontacioni e pastaj me

vendimin e Gjykatës për miratimin e marrëveshjes për zgjidhjen e ndërmjetësuar MCMS:27/2014 datës 18.03.2014 është vendosur që të dëmtuarës NS ne emër të kompensimit të demit ti paguat shuma 2000 mijë euro si dhe shpenzimet e procedurës për të autorizuarin Av.MH ne shumë prej 239 euro.

Në shqyrtimin gjyqësor e autorizuar e paditësit LH ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke theksuar se fillimisht e bëjmë precizimin e kërkesëpadisë ne aspektin objektiv ashtu që vlera për të cilën paditësja kërkon që të rimburohet nga shkaktari i aksidentit është 3739 euro e jo sikurse ka qen e cekur ne padi pasi që nga shkresat e lendes rezulton se gabimisht 151 euro janë transferuar avokatit të të dëmtuarës ne kohën kur është kompensuar personi i tret NS. Në fjalën përfundimtare ka shtuar se nga provat e administruara, është vërtetuar baza juridike e kërkesë-padisë, andaj i ka propozuar gjykatës ta aprovoj në tërësi sit ë pabazuar padinë si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale.

I autorizuari i të paditurit Av.AD në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se e kundërshtoi ne tersi padinë dhe kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, nga baza për faktin se rasti nuk ka ndodhur siç ka shkruar ne raportin policor ngase shkaktar i shkaktimit të këtij aksidenti ka qene automjeti i udhëtareve i pa identifikuar me të cilin goditet motoçikleta e të paditurit e duke pasur parasysh se i padituri rrezohet dhe pëson lëndime, ku i njëjti dërgohet për shërim dhe për këtë arsye nuk ka pasur mundësi që të merr të dhënat e automjetit i cili ka shkaktuar aksidentin, i propozoj Gjykatës që me qëllim të vërtetimit të bazës të nxirret ekspertiza nga lemia e komunikacionit. Pas nxjerrjes së ekspertizës nga lemia e komunikacionit ne seancën e shqyrtimit i njëjti ka deklaruar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë si dhe precizimin e saj për faktin se sipas deklaramit të ekspertit ne shqyrtim gjyqësor nuk përjashtohet mundësia që i padituri të jete goditur nga ndonjë automjet ne pjesën e prapme të motoçikletës, se i padituri nuk është i detyruar ta beje rimbursimin e demit dhe shpenzimeve, ku shkaktar i këtij aksidenti mund të jete personi (NN), andaj konsideroj se fare nuk është dashur të zhvillohet një procedure për rimbursim të demit, andaj i propozoj Gjykatës që ta refuzojë kërkesëpadinë, shpenzimet e procedurës i kërkoj. Në fjalën përfundimtare ka shtuar se sa i përket lartësisë i autorizuari i të paditurit konsideron se vendimin përfundimtar për kompensim të demit është marrëveshja për zgjidhjen me ndërmjetësim e datës 18.03.2014, ku nga dispozitivi i kësaj shihet se paditësi palës se dëmtuar i ka paguar shumën prej 2000 Euro, si kompensim të demit pasuror e jo shumën e kërkuar sipas Padisë, andaj se edhe nëse Gjykata konsideron se i padituri duhet të beje rimbursim, rimbursimi duhet të jete sipas vendimit gjyqësor të datës 18.03.2014, ndërsa shpenzimet nuk janë shkaktuar me fajin e të paditurit, andaj konsiderojmë se nuk ka detyrim të rimburoje i padituri, ndërsa e kontestoj ne tërësi shumën ne emër të akontacionit.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bere leximin e ujdia jashtëgjyqësore e dt, transferi i dt, raporti policor te dt 19.09.2012, ftesa për prezentimin e shërbimeve të ndërmjetësimit e dt, vendimi nga BKS i dt 03.06.2013 me të cilin i është dhënë të dëmtuarës si oferte e fundit që të arrihet të zgjidhet kjo çështje brenda BKS pa kaluar ne procedura tjera, urdhertransferi nga BKS e dt 29.04.2014, vendimi I gjykatës për miratimin e marrëveshjes për zgjedhje të ndërmjetësuar dt, formulari për kompensim të demit dt. 03.06.2013, vlerësimi mjekësor dt 24.05.2013, transferi bankar i dt 16.04.2013, vendimi i komisionit të shkallës së parë për trajtimin e

demeve nga BKS dt 03.06.2013, kërkesa për dhënie te avansit nga ana e te autorizuarit te dëmtuarës, flete lëshimi me epikrize ku konstatohet se e dëmtuara është mjekuar nga dt 18.03.2013 deri me 05.04.2013, raporti I kujdesit emergjent-Spitali Rajonale i Mitrovicës 19.09.2013, fleteleshimi nga QKUK -Klinika Ortopedisë ku konstatohet se e dëmtuara është mjekuar nga dt 19.09.2012 deri me 05.10.2012, fotografitë e te dëmtuarës, urdhertransferi dt 10.01.2013, vendimi nga BKS dt 13.12.2012, kërkesa për dëmshpërblim dt 10.10.2012, ekspetiza e ekspertit te komunikacionit te dt 02.03.2018.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartcekur, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Në bazë të raportit të Policisë mbi aksidentin e komunikacionit me nr. nr.2012-BC-1429 të datës 19.09.2012, gjykata ka provuar fakti se me datën 19.09.2012 në Rr. “.....”, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, në mesë të paditurit EZ nga Mitrovica, dhe të dëmtuarit NS nga Mitrovica, në të cilin aksident lëndime trupore kanë pësuar NS.

Duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit ISB të datës 02/03/2018, të cilën ekspertizë e ka mbrojtur edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, vihet në përfundim, se deri në shkaktimin e aksidentit të datës 19/09/2012, në, në rrugën “....”, ka ardhur si rezultat i lëshimeve primare të drejtuesit (këtu i padituri) të Motoçikletes, konkretisht si pasoj e shpejtësisë jo adekuate sipas kushteve te krijuara ne komunikacion edhe pse shpejtësia ka qen rreth 40 (km/h) ne zonën e kufizuar 40 (km/h), përkatësisht nga moskujdesi ne ngasje dhe jo vigjilenca e ngasësit ndersa personi i dëmtuar NS nuk i ka dhënë kontribut aksidentit..

Gjykata pas analizimit të ekspertizës në fjalë, në raport me faktet dhe provat të cilat ndodhën në shkresat e lëndës, ia fali besimi e plotë, pasi që e njëjta është përpiluar mbi bazën e njohurive shkencore dhe profesionale nga eksperti i lëmit përkatës.

Në bazë të leximit të pasqyrës së pagesës së datës 16.04.2013, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja të dëmtuarës fillimisht ju është kompensuar akontacioni në shumë prej 1.500 euro në llogarinë bankare te te autorizuarit te dëmtuarve nr. 1503001003571144 sipas numrit të rastit BKS-FK 1766/12, ndërsa ne bazë të leximit të pasqyrës së pagesës së datës 07.05.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja të dëmtuarës ju është kompensuar demi në shumë prej 2,390 euro në llogarinë bankare te te autorizuarit te dëmtuarve nr. 1503001003571144 sipas numrit të rastit BKS-FK 1766/12

Në bazë të urdhër transferim me numër 1766/12 të datës 10.01.2013, gjykata ka vërtetuar faktin, se Paditësja (BKS) ka urdhëruar fondin e kompensimit që ti paguhen klientit NS, që në emër të akontacionit ti paguhet shuma prej 1500 euro sipas Ujdisë jashtëgjyqësore, ndërsa në bazë të urdhër transferim me numër 1766/12 të datës 29.04.2014, gjykata ka vërtetuar faktin, se Paditësja (BKS) ka urdhëruar fondin e kompensimit që ti paguhen klientit NS, që në emër të kompensoi demin material dhe jo material ti paguhet shuma prej 2390 euro sipas Ujdisë jashtëgjyqësore ta arritur ne procedurë te ndërmjetësimit.

Në bazë të leximit të Ujdisë jashtëgjyqësore të datës 10.01.2013, gjykata ka konstatuar faktin se Paditësja (BKS) ka lidhur ujdj jashtë gjyqësore me të dëmtuarën NS, të cilën e

përfaqëson Av.MH, me anë të së cilës janë dakorduar që të dëmtuarës të i paguhet shuma e të hollave prej 1500 euro, në emër të akontacionit, ndërsa në bazë të leximit të Ujdisë jashtëgjyqësore te arritur ne procedurën e ndërmjetësimit të datës 18.03.2014, gjykata ka konstatuar faktin se Padiësja (BKS) ka lidhur ujdj jashtë gjyqësore me të dëmtuarën NS, të cilën e përfaqëson Av.MH, me anë të së cilës janë dakorduar që të dëmtuarës të i paguhet shuma e të hollave prej 2000 euro ne emër kompensimit të dëmit ndersa 239 euro ne emër te shpenzimeve te procedurës.

Baza ligjore

Sipas nenit 18.1 1. Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia I cili parasheh që “ *Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësise, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja*”, ndërkaq Sipas nenit 12 par. 1të po të njëjtit Ligj “*Fondet e sigurimeve shëndetësore, personale dhe invalide kanë të drejtë, lidhur me detyrimet e përmbushura ndaj siguruesve të tyre, të parashtrajnë kërkesa regresi nga baza e sigurimit të auto përgjegjësise për rimbursimin e dëmit real, brenda kufijve të përgjegjësise të siguruarit me kontratë, pasi që ato janë paguar*”. me nenin 3.1 par.2 të Rregullës 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto përgjegjësise të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. AI/2001/2, parashihet se “*kompania e sigurimit e cila ka paguar zhdëmtimin pa qenë e detyruar ta paguaj atë në bazë të kontratës së sigurimit dhe kushteve të sigurimit të detyrueshëm të auto përgjegjësise, e subrugon të dëmtuarin në relacion me të siguruarin apo çdo person tjetër përgjegjës, për dëmin deri në shumën e zhdëmtuar, kamatën dhe shpenzimet*”.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave të lartpërndura dhe thënieve të palës paditëse ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet në tërësi sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Kjo ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar është provuar fakti se me datën 19.09.2012 në Rr. “.....”, kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit, ku shkaktar i aksidentit kishte qenë këtu i padituri EZ, i cili në momentin e shkaktimit të aksidentit Motoçikletën e ka pasur të pa siguruar, dhe në të cilin aksident dëm material dhe jo materiale kishte pësuar e dëmtuara NS. Po ashtu në bazë të provave të lartcekura, është provuar se këtu padiësja i’ a kishte paguar të dëmtuarës në aksidentin e komunikacionit të datës 19.09.2012, NS, shumën në lartësi prej 3890 euro. Gjykata ka vërtetuar edhe faktin se si rezultat i një gabimi teknik nga padiësja BKS, 151 euro jan transferuar gabimisht avokatit te te dëmtuarës, për çka e autorizuar e paditëses BKS ne seancën e datës 18.04.2018 hoqi dorë nga kjo pjesë duke precizuar kërkesëpadinë ne shume prej 3739 euro. Andaj mbi bazën e të lartcekurave dhe në kuptim të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, gjykata gjeti se kërkesëpadia e precizuar e paditëses është e bazuar dhe të njëjtën edhe e aprovoi në tërësi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pretendimet e të autorizuarit të të paditurit në lidhje me atë se shkaktari i këtij aksidenti është i panjohur NN, gjykata i refuzoi si te pa bazuar për faktin se i njëjti me asnjë prove te vetme ne këtë procedurë nuk i argumentoi pretendimet e tilla.

Gjykata ka administruar edhe prova tjera siç janë: kërkesën për dëm shpërblim nga Familja, dokumentacioni mjekësor, gjykata gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim në nxjerrjen e vendimit, andaj të njëjtat nuk i analizoi veç e veç.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së dhe atë për shpenzimet si në vijim: 20 euro ne emër te taksës për padi.

Nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.672/2015 datë 07.05.2018

Gjyqtari,
Naim Mehulli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve, pas marrjes se të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.